

BIO E ANETAREVE TE KESHILLIT DREJTUES

KATHRYN SWINTEK

Kathryn Swintek, drejtuese në këshillin drejtues dhe udhëheqëse biznesi me një eksperiencë të gjerë ndërkombëtare në institucione financiare. Ajo është Partnere Drejtuese dhe anëtare e Komitetit të Investimeve në Fondin Golden Seeds 2, fond ky që investon në kompani të sapo-themeluara në SHBA te cilat drejtohen nga gra dhe operojnë në fushën e kujdesit shëndetësor, teknologjisë, SaaS dhe sektorit konsumator/ e-commerce.

Znj. Swintek është gjithashtu drejtuese në disa shoqëri: Strata Skin Sciences, (Kryetare e Komitetit të Kontrollit), në shoqërinë Turtle & Hughes, (Kryetare e Komitetit të Kontrollit), Open Road Integrated Media, Oculogica dhe Bergen Medical Products, dhe është Kryetare e Këshillit Drejtues të Bankës Amerikane të Investimeve me qendër në Shqipëri. Më parë Znj. Swintek ka qenë Drejtuese e shoqërisë C200 (www.c200.org) dhe e Forumit të Gruas në New York si edhe administratore në Kolegjin e Mt. St.Vincent. Ajo është drejtuese e kompanisë teatrale, fituese të shumë çmimeve, MINT (NYC), anëtare e Këshillit Kombëtar të Shtypit Graywolf (Minneapolis) dhe anëtare e shoqërisë Gratë Drejtuese të Korporatave (WCD).

Znj. Swintek ka qenë drejtuese e lartë ekzekutive në sektorin e investimeve bankare në një nga grupet më të mëdha bankare ndërkombëtare, BNP Paribas, në New York dhe Londër. Gjatë eksperiencës 20 vjeçare me këtë grup, ajo ka mbuluar pozicione të larta drejtuese në disa njësi, duke përfshirë pozicionin e Drejtueses Ndërkombëtare në njësinë e High Yield Bond, Drejtuese e njësisë së Strukturimeve Financiare në SHBA, Drejtuese në njësinë për Amerikën Veriore në Leveraged Finance dhe bashkë-drejtuese në njësinë ndërkombëtare të Sponsor Coverage. Përpara BNP Paribas, ajo ka punuar në shoqërinë Irving Trust (sot BNY Mellon) si Oficere Bankare në njësinë e Lindjes së Mesme dhe Afrikës, përfaqësuese për Francën me qendër në Paris, si dhe Zv. Presidente e Lartë dhe Drejtore e Divizionit të Financave të Blerjeve.

Znj. Swintek është diplomuar në Ekonomiks në Kolegjin e MT. St. Vincent dhe ka një Master në Administrim Biznesi në Financë nga Universiteti i New York. Zotëron frëngjishten dhe ka shtetësi të dyfishtë, amerikane dhe franceze.

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al

REZZO SCHLAUCH

Rezzo Schlauch është një politikan i shquar në Gjermani dhe jashtë vendit. Z. Schlauch është i angazhuar në këshillin mbikëqyrës dhe është këshillues i disa kompanive dhe agjencie ndërkombëtare, si p.sh. INSPAT (Agjencia Turke e Mbështetjes së Investimeve dhe Promovimit), Deloitte & Touche GmbH, Cortent Kommunikation AG, MWI AG, KWA Contracting AG, DMK Deutsches Milchkontor GmbH, Concilius AG dhe Manda Panda Trade & Consult GmbH etj.

Si anëtar i Partisë së Gjelbër që prej vitit 1980, Z. Schlauch u zgjodh në Dhomën e Ulët të Parlamentit Gjerman. Në fillim të koalicionit të parë të kuq/të gjelbër në vjeshtën e vitit 1998, ai ishte kryetari i grupit të Gjelbër deri në vitin 2002. Në legjislacionin e tij të dytë deri në tetor të vitit 2005, ai ishte Sekretar Shteti i Parlamentit. Që prej dhjetorit 2005, Z. Schlauch ka bashkëpunuar dhe është aktualisht partner në firmën ligjore ndërkombëtare Mayer & Kambli në Munihi.

Z. Schlauch ka filluar studimet në Universitetin e Heidelberg ne vitin 1968 dhe ka filluar të ushtrojë profesionin e avokatit që në vitin 1975.

MARK CRAWFORD

Mark Crawford është marrë prej dy dekadash me sipërmarrje dhe menaxhim. Ai është angazhuar me kompani të shumta financuese, ku përfshihen tre banka në zhvillim, një firmë ndërkombëtare broker dhe disa institucione financiare jo-bankë. Z. Crawford është Administratori i Fondit Shqiptaro-Amerikan, i cili është autorizuar nga Akti i Kongresit, nën presidencën e George H.W. Bush, dhe më vonë i asimiluar nën presidencën Clinton. Z. Crawford ka qenë partner me BDO audit & advisory. Ai është aktualisht në Bordin Këshillues të një kompanie kanadeze publike që merret me burimet natyrore. Z. Crawford gjithashtu ka dhënë leksione në universitete në dy kontinente.

Z. Crawford ka punuar vullnetarisht me stafin e Departamentit të Thesarit të SHBA në një studim mbi tregjet e kapitalit në Kosovë dhe aktualisht punon vullnetarisht pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, si President Pro-Bono i Këshillit Drejtues të Dhomës Amerikane të Tregtisë. Gjithashtu, Z. Crawford është Kryetar vullnetar i një filiali ndërkombëtar të Campus Crusade for Christ. Z. Crawford është aktualisht Zv. Presidenti Global për Çështjet Legjislative për Republikanët jashtë vendit.

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al

Ai është qytetar amerikan, lindur në Kaliforni, rritur dhe banor në Ohio. Z. Crawford është diplomuar nga Miami University (Ohio) dhe ka marrë një diplomë Master nga University College London në Mbretërinë e Bashkuar. Gjuha amtare e Mark Crawford është anglishtja, flet shumë mirë gjuhën shqipe dhe pak atë serbe, malazeze dhe greke.

KRISTIN L. GIANTRIS

Kristin Giantris ka mbi 25 vjet eksperiencë në fushat e zhvillimit ekonomik dhe financë. Ajo ka ngritur dhe aplikuar ekspertizën e saj në sektorin social dhe privat sikurse dhe ka drejtuar ekipe dhe projekte ndërkombëtare dhe në gjithë SHBA-në. Puna e saj në zhvillimin ekonomik është fokusuar në Evropën Qendrore dhe Lindore, veçanërisht në Shqipëri.

Znj. Giantris ka qenë Përfaqësuese për OJQ ndërkombëtare në Shqipëri dhe projekte të USAID, sikurse dhe Këshilltare e IFC për financat vendore në Ministrinë e Financave të RSH. Eksperienca e Znj. Giantris në sektorin e bankingut privat ka qenë me Citigroup ku ajo mbulonte klientët e institucioneve financiare bankare nga Azia, Australia, Kanadaja dhe Evropa, të cilët hynin në tregun e të ardhurave fikse në SHBA. Aktualisht Znj. Giantris është Drejtuese e Lartë për Këshillimin Financiar për një Fond Financiar Jofitimprurës, ku ajo drejton krijimin dhe zbatimin e mjeteve financiare inovative dhe shërbimet këshilluese të cilat kanë ndikim social dhe financiar dhe menaxhon një ekip kombëtar.

Znj. Giantris është pjesë e disa bordeve dhe komiteteve këshilluese në SHBA dhe më gjerë. Ajo është themeluese dhe aktualisht Kryetare e Bordit për The Access Challenge, një organizatë globale për mbështetjen e shëndetit publik.. Ajo është anëtare e këshillit drejtues në Downtown Art, një organizatë e arteve dhe drejtësisë shoqërore në New York City. Për më shumë znj. Giantris është anëtare në Komitetin Këshillues të Çmimit të Kulturës së Shëndetit të Fondacionit Robert Wood Johnson, ashtu si dhe pjesë e Komisionit Value-Based Payment në NYC.

Znj. Giantris ka master në politikat publike nga Shkolla e Punëve Publike dhe Ndërkombëtare nga Universiteti i Kolumbias, një Diplomë (BA) në shkencat politike nga Kolegji Kenyon dhe ka ndjekur Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Zagrebit. Znj. Giantris ka lindur dhe është rritur në SHBA, me origjinë nga Korça, Shqipëri.

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al

ROBERTO MUÑOZ

Roberto Muñoz sjell një eksperiencë financiare më shumë se 35 vjeçare në rolin e tij drejtues në Florida Community Bank (FCB) si Drejtues i Thesarit dhe Bankingut Tregtar për Rajonin Miami-Dade dhe Florida Jugore.

Gjatë karrierës së tij bankare, Z. Muñoz ka punuar për aktivitete ekonomike me vlerë për më shumë se \$27 bilion në Florida, Karaibe, Amerikën Qendrore dhe Amerikën Jugore në fushat e financimit të projekteve, bashkimeve dhe blerjeve (M&A), investimeve të huaja direkte dhe indirekte në fushat e tregtisë, kredi dhënies publike, institucionale dhe të specializuar, ashtu sikurse dhe në fushën e pasurive globale dhe shërbimeve të menaxhimit të thesarit. Z. Muñoz ka mbajtur pozicione drejtuese në Miami me BBVA Compass Bank, Professional Bank, Marquis Bank (president dhe Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv), Regions Bank, Israel Discount Bank, Mizuho Bank, dhe Barclay's Bank.

Z. Muñoz është kryetar për vitin 2019 i World Trade Center Miami, dhe mban pozicione drejtuese në Organizata qytetare të tjera në Florida Jugore. Ai është drejtor thesari dhe kryetar i komitetit të financës i Dhomës së Lartë të Tregtisë së Miami dhe ish kryetar e president i Shoqatës së Bankierëve Ndërkombëtar të Floridas, ku ka shërbyer si kryetar themelues i Komitetit të Tregjeve Aziatike. Ai është gjithashtu pjesë e bordeve këshillues dhe ekzekutiv të Center for Financial Training Southeastern Chapter, bordit këshillues të Qendra për Lidërsip në Universitetin Ndërkombëtar të Floridas; dhe është anëtar i Shoqatës së Biznesit të Hong Kong në Florida.

Z. Muñoz ka lindur në Panama me prindër Amerikan dhe ka jetuar në Hong Kong për gjashtë vjet deri në adoleshencën e tij. Pas transferimit në Miami, ai mori diplomë të asociuar nga Miami-Dade College dhe diplomë në biznes ndërkombëtar dhe financë nga Universiteti Ndërkombëtar i Floridas. Ai është profesor i jashtëm në Universitetin Ndërkombëtar të Floridës.

Z. Muñoz është anëtar ekzekutiv bordi i Këshillit të Floridas se Jugut të Boy Scouts të Amerikës; anëtar bordi i Chapman Partnership for the Homeless; anëtar i besuar i bordit të Shoqërisë së Leucemisë dhe Limfomës për Floridan e Jugut. Duke reflektuar përkushtimin e tij për komunitetin, Z. Muñoz ka marrë shumë çmime dhe mirënjohje.

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al

ANDI BALLTA

Andi Ballta ka një eksperiencë të gjatë në sektorin bankar në SHBA dhe Evropë.

Z. Ballta, që nga 2008, është një ndër Menaxherët në drejtim të NCH Capital Inc., një shoqëri investimesh private me qendër në New York.

Deri në 2014 ai ishte përfaqësues i NCH Capital Inc. për mundësitë investuese në Shqipëri, Bosnjë, Kroaci, Maqedoni, Greqi, Kosovë dhe Mali i Zi. Gjatë kësaj kohe ai drejtoi blerjen dhe menaxhoi një portofol rajonal të pronave në bregdetin Grek apo atë të Ballkanit Perëndimor për zhvillime turistike. Në korrik 2014, fokusi i tij kryesor u zhvendos drejt menaxhimit dhe rritjes së Tranzit Finance ShPK e cila është shoqëri e krijuar nga fondet e NCH Capital Inc., me qëllim blerjen, mbledhjen dhe financimin e portofolit të borxheve.

Në 2015, pas blerjes së Crédit Agricole Shqipëri ShA nga Tranzit Finance ShPK, Z. Ballta u bë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës Amerikane të Investimeve ShA.

Z. Ballta, përpara se t'i bashkohej NCH Capital Inc., punoi për shtatë vjet në Israel Discount Bank në New York dhe Miami si Zv. President i lartë – Drejtues i Financimeve në Sindikatë dhe të Sponsorizuara. Në këtë pozicion, ai menaxhoi një ekip të blerjes së kredive me interes të lartë, biznese ndihmës, strukturime, vlerësim të kredive dhe tregtim në tregun primar dhe sekondar. Në mesin e viteve 1990 në Shqipëri, Z. Ballta ka asistuar ndërmarrje te vogla dhe të mesme në procesin e privatizimit dhe në lehtësimin e investimeve direkte në vend.

Z. Ballta ka mbaruar studimet për Administrim Biznesi në Universitetin Shtetëror të Tiranës dhe ka një Master nga Universiteti i Shën Thomas në Miami, Florida (MBA).

ARMAND MUHARREMI

Armand Muharremi, aktualisht Drejtor i Divizionit të Financës së Bankës ka një eksperiencë të gjerë në sektorin bankar, të taksave dhe të auditit.

Z. Muharremi filloi karrierën e tij me KPMG Shqipëri si auditor, dhe shumë shpejt u promovua si Supervisor i Auditit. Ai vazhdoi karrierën e tij në Auditim në bankën Societe Generale Shqipëri ShA në vitin 2004 në pozicionin e Drejtuesit të Kontrollit të Brendshëm dhe më vonë Drejtues në Divizionin e Financës. Z. Muharremi vijoi karrierën e tij në Audit dhe Financë me Ernst & Jung

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al

(2009 – 2011) dhe me Crédit Agricole Shqipëri ShA që prej vitit 2011 si Drejtor i Divizionit të Financës. Eksperienca e tij e gjatë në sistemin bankar në Shqipëri është një avantazh i madh për bankën.

Z. Muharremi është diplomuar nga Universiteti i Tiranës, për Menaxhim Biznesi në vitin 1998.

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al